



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

VENDIM

Nr. 175 Prot

Shkodër me 17.03 2025

Nr. 06, Datë 13.03.2025

“Mbi disa ndryshime në VKQ nr. 26, datë 20.12.2024 ”Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA Përfundimtar 2025-2027 ”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 13.03.2025, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Mbi disa ndryshime në VKQ nr. 26, datë 20.12.2024 ”Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA Përfundimtar 2025-2027”, bazuar nën 38 e 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.97/2023 “Per Buxhetin e Vitit 2023”, pikat 3 e 4 të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKQShkoder nr.26, datë 29.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA Përfundimtar 2025-2027”, pika 2 e VKQ Shkoder nr.30, datë 20.12.2024 “Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2025 për Këshillin e Qarkut Shkodër”, VKB nr.76, datë 19.12.2024 të Bashkisë Shkodër, VKB nr.81, datë 31.12.2024 të Bashkisë Malësi e Madhe, VKB nr.84, datë 23.12.2024 të Bashkisë Vau Dejës, VKB nr.64, datë 23.12.2024 të Bashkisë Fushë Arrëz si dhe VKB nr.64, datë 27.12.2024 të Bashkisë Pukë, pika 190 e udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 të MF “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr.10, datë 12.07.2024 “Për rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin e fondeve të Financimeve të Huaja në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare”, kontratës së grantit të nënshkruar me datën 12.03.2018 për projektin ADRIATICAVES, , Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **12 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim**,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në pikën 1/e të buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025, pas miratimit të Kuotës së antarësisë që Bashkitë e Qarkut Shkodër i financojnë

Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025, shtesë në planin e të ardhurave në shumën 1,940,000 lekë.

- a. Kuota e Antarësisë, që bashkitë kanë planifikuar të financojnë Qarkun Shkodër për vitin 2025 do të jetë si më poshtë;

➤ Bashkia Shkodër	shuma	1,000,000 lekë
➤ Bashkia Vau Dejës	shuma	600,000 lekë
➤ Bashkia Malësi e Madhe	shuma	200,000 lekë
➤ Bashkia Fushë Arrëz	shuma	100,000 leke
➤ Bashkia Pukë	shuma	40,000 leke
Totali		1,940,000 leke

- b. Shuma 1,940,000 lekë të përdoret për mirëmbajtje në disa objekte të Bashkisë Shkodër, sipas preventivave dhe marrëveshjes me Bashkinë Shkodër.

SHTOHET

Progr. 01110 Art. 6025 "Shpenzime mirëmbajtje në objekte" në shumën **1,940,000 lekë**.

2. Të miratohet transferimi i fondit të planifikuar në buxhetin e vitit 2025 për investimin "Rikonstruksion i rrugës së varrezave Mëlgushë, Bashkia Vau Dejës", në shumën prej 12,000,000 lekësh, nga Këshilli i Qarkut Shkodër në Bashkinë Vau Dejës. Ky fond do të përdoret për këtë investim por nga Bashkia Vau Dejës.

Shtohet;

Prog.01110,Kap1,Art.604 "Transferte e brendshme për investimin-Rikonstruksion i rrugës së varrezave Mëlgushë, Bashkia Vau Dejës", **shuma 12,000,000 lekë**

Pakësohet

Prog.01110,Kap1,Art.231 "Investimin-Rikonstruksion i rrugës së varrezave Mëlgushë, Bashkia Vau Dejës",kod projekti 0330077, **shuma 12,000,000 lekë**.

3. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të trashëguara nga viti 2024 për vitin 2025 si më poshtë;
- Fondet e mbetura të papërdorura në Progr.01110, Art.231,Kap.1, në shumën **18,000 lekë**, përkatsisht "Te tjera paisje zyre", me kod projekti 0330006 , të pakësohen .
 - Fondet e mbetura të papërdorura në Art.230, Kap.5, kod projekti 0330075 "Projektim, sistemim, rruga Bardhaj Qafe Rrenc" në shumën **68,415 lekë**.
 - Fondet e mbetura në art.231 në Kap.1, kod projekti 0330045 "Mbikqyrje punimesh rruga Bardhaj Qafe Rrenc, FIHI" në shumën **205,333 lekë**, të pakësohen.
 - Fondet e mbetura të papërdorura në art.231 në Kap.5, kod projekti 0330009 "Mbikqyrje punimesh Rikonstruks Fasadash" në shumën **67,392 lekë**, të pakësohen.
 - Fondet e mbetura të papërdorura në art.231 në Kap.1, kod projekti 0330054 "Kolaudim Ujeshjellësi Muriqan" në shumën **192,139 lekë**, të pakësohen.
 - Fondet e mbetura të papërdorura në art.605 në Kap.1,Transferime korrente me jashtë, në shumën **461,202 lekë**, të përdoren në të njëjtin artukull për vitin 2025.
 - Fondet e mbetura të papërdorura në art.609 në Kap.1, në shumën **1,000,000 lekë**, të pakësohen.
 - Fondet e mbetura në art. 602 "Shpenzime operative", në Kap.1 në shumën **2,500,000 lekë** të planifikuara për tu përdorë për mirembajtjen e objektit dhe shuma **490,671 lekë**, të pakësohen. Pjesa tjeter e fondeve në art.602, të shtohet në art.6029006 "Pagesa keshilltaresh" për pagesat e vitit 2025.

- Fondet e mbetura të papërdorura në Progr.01110, Art.231,Kap.1, "Orendi Zyre" me kod 0330021, në shumën **4,000 lekë** te perdoren në të njëjtin kod projekti për vitin 2025.
- Nga fondet e mbetura të papërdorura që pakësohen më sipër, Kap 1 dhe 5, shuma **4,500,000 lekë** të përdoret për blerje materiale (Kabell elektrik) për Bashkinë Shkodër, në Progr.01110, Art.602 dhe shuma **41,950 lekë** të përdoret për blerje "Orendi Zyre", Art.231, me kod 0330021.

Pakësimi nga fondet e trashëguara nga viti 2024

				lekë
Nr.	Kap.	Art.	Emertimi	Shuma
1	1	602	Shpenzime Operative	2,990,671
2	1	609	Fond Rezerve dhe kontigjence	1,000,000
3	1	231	Te tjera paisje zyre	18,000
4	1	231	Supervizor rruga Bardhaj Renc Faza III	205,333
5	1	231	Kolaudim Ndertim Ujësjiellëi	192,139
6	5	231	Mbikqyrje punimesh	67,392
7	5	230	Projektim investimi i rruges Bardhaj Rrenc	68,415
			Totali	4,541,950

Shtesë viti 2025

				lekë
Nr.	Kap.	Art.	Emertimi	Shuma
1	1	231	Orendi Zyre	41,950
2	1	602	Shpenzime operative	4,364,193
3	5	602	Shpenzime operative	135,807
			Totali	4,541,950

4. Të miratojë transferimin e fondit të mbetur gjendje në llogarinë e thesarit nga projekti ADRIATICAVES në shumën 2,231,164 lekë, nga llogaria e dedikuar e projektit ADRIATICAVES, tek të ardhurat e Këshillit të Qarkut Shkodër. Nga shuma e mësipërme, vlera 1,470,000 lekë të përdoret në funksion të bashkëfinancimit 15% të projektit SMARTMOBAIR.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder .
6. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI
Edmond NDOU

